



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 555, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË, TË DISA KLASAVE TË ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Dituri natyre”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës bërthamë, për klasën e pestë, klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit bazë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 17, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
18. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë (frënge, italiane, gjermane), për shkollat me marrëveshje me ambasadat", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 18, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
19. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 19, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

20. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 20, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
21. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 21, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
22. Programet mësimore të klasës së parë dhe klasës së gjashtë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
23. Programet mësimore të klasës së shtatë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
24. Programi mësimor i klasës së pestë hyn në fuqi dhe fillon zbatimin në vitin shkollor 2029 – 2030.
25. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.
26. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “GJUHË E HUAJ E DYTË” ARSIMI I MESËM I ULËT KLASAT 6-7

**FUSHA “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”
PROGRAM I PËRDITËSUAR**

Koordinator: Ludmilla Stefani



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT LËNDOR “GJUHË E HUAJ E DYTË” (KLASA VI-VII)

1	HYRJE	4
2	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	4
3	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	7
4	KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA.....	9
4.1	Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit	9
4.2	Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e gjuhës së huaj të dytë	13
4.3	Kompetencat e lëndës së gjuhës së huaj të dytë dhe rezultatet e të nxënit	15
5	PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	18
5.1	Koha mësimore për klasën e gjashtë dhe të shtatë	18
5.2	Përmbajtja e klasës së gjashtë dhe të shtatë	20
5.3	Veprimtari gjuhësore	22
5.4	Strategji komunikimi.....	25
5.5	Kompetenca shumë gjuhësore dhe shumë kulturore.....	26
5.6	Qëndrime dhe vlera	27
5.7	Formimi kulturor dhe ndërkulturor	28
5.8	Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).	28
6	METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES.....	30
6.1	Qasja e orientuar drejt veprimit.....	30

6.2	Roli i situatave praktike në mësimin e gjuhës së huaj.....	33
6.3	Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjuhës së huaj	34
6.4	Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ).....	35
6.5	Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjuhës së huaj	36
6.6	Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës së huaj	37
7	VLERËSIMI I NXËNËSVE	38
7.1	Llojet e vlerësimit në lëndën e gjuhës së huaj.....	38
7.2	Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e gjuhës së huaj.....	39
7.3	Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.	40
8	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE	41
8.1	Përdorimi i teknologjisë si mjet dhe teknikë mësimore	41
9	REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	43
10	NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE.....	47
11	TABELA E NIVELEVE SIPAS KLASAVE	48
12	ANEKSI 1- GJUHË FRËNGE	49
13	ANEKSI 2 – GJUHË ITALIANE	67
14	ANEKSI 3- GJUHË GJERMANE	83

1 HYRJE

Gjuha e huaj e dytë në arsimin e mesëm të ulët i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre të komunikimit dhe të kuptojnë botën përmes një perspektive globale. Si gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, e shkencës, teknologjisë, biznesit dhe kulturës, gjuha e huaj jo vetëm i pajis nxënësit me njohuri dhe aftësi gjuhësore, por gjithashtu ju hap dyer për mundësi të reja në edukim dhe në karrierë.

Programi i gjuhës së huaj të dytë për klasën e gjashtë dhe të shtatë është i ndërlidhur ngushtë me lëndët e tjera, si shkencat shoqërore, letërsia, teknologjia, etj. Njohuritë e fituara në gjuhën e huaj ndihmojnë në kuptimin më të thellë të koncepteve në histori dhe sociologji, si dhe në analizën e veprave letrare. Aftësitë e fituara në gjuhën e huaj u japin nxënësve mundësinë të hulumtojnë materiale shkencore, të kuptojnë koncepte komplekse dhe të aplikojnë njohuritë e marra në situata praktike nga jeta reale. Kjo lidhje e fortë e gjuhës së huaj me lëndët e tjera ndihmon nxënësit të shohin rëndësinë e gjuhëve në kontekstin e një arsimit të gjithanshëm.

Programi i gjuhës së huaj të dytë është hartuar për të përmbushur nevojat e çdo nxënësi, duke ofruar përmbajtje të pasur, aktivitete krijuese dhe përdorim të teknologjisë së informacionit. Qasja e orientuar drejt veprimit dhe angazhimi në projekte nga jeta reale janë faktorë të rëndësishëm që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë rolin e gjuhës së huaj si pjesë e botës moderne dhe të zhvillojnë besimin në aftësitë e tyre.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Programi i gjuhës së huaj për klasën VI-VII është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe Volumit Shoqërues dhe promovon shumë gjuhësinë, ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e diversitetit gjuhësor dhe kulturor.

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në klasën VI. Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane, dhe gjuhë të tjera sipas specifikave të institucionit arsimor.

Qëllimi kryesor i mësimi të gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të ulët është të zhvillojë aftësitë gjuhësore të nxënësve dhe t'i përgatisë ata për të komunikuar në mënyrë efektive në mjedise të ndryshme kulturore dhe profesionale.

Programi synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësim nxënies dhe vlerësimit me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimi dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Programi hartohet mbi interesat dhe karakteristikat e grup moshës dhe ndihmon në zhvillimin intelektual dhe socio-kulturor të nxënësit duke e fuqizuar atë të jetë i pavarur, krijues, i motivuar dhe i gatshëm për tu përballur me sfidat e së ardhmes dhe të nxënit gjatë gjithë jetës.

Nxënësi në klasën VI fillon nivelin gjuhësor A1.

Nxënësi në fund të këtij niveli kupton fjali dhe shprehje të përdorura shpesh në lidhje me fusha që kanë përparësi imediate dhe komunikon gjatë kryerjes së detyrave që kërkojnë një shkëmbim të thjeshtë informacioni të drejtpërdrejtë, mbi tema të njohura për të. Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit A1 sipas shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët ku nxënësi njihet si përdorues i nivelit mesatar ose “mbijetesë gjuhësore”.

Tabela 1: Përshkrimi i nivelit A1 sipas shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët

A1	Nxënësi: - Mund të kuptojë dhe të përdorë shprehje të përditshme dhe shprehje bazë që synojnë plotësimin e nevojave konkrete. - Mund të prezantojë vehten dhe të tjerët dhe të pyesë e të përgjigjet për detaje vetjake si: ku jeton, banon, njerëzit që njeh, sendet që ka etj. - Mund të komunikojë në një mënyrë të thjeshtë nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë, qartë dhe është i gatshëm të ndihmojë.
----	--

Programi i gjuhës së huaj synon të zhvillojë tek nxënësi një sërë aftësish të transferueshme për të kuptuar dhe komunikuar në situata që has në jetën e përditshme. Nxënësi forcon jo vetëm vetëdijen kulturore për vendet dhe popujt e tjerë, por edhe aftësitë gjuhësore të nevojshme që do ta ndihmojnë atë për të studiuar ose për tu punësuar në të ardhmen. Kjo qasje i inkurajon nxënësit të jenë:

- *të sigurt* për të përdorur struktura gramatikore dhe fjalor të shumëllojshëm për të komunikuar me të tjerët në situata të përditshme;
- *të përgjegjshëm* për të kërkuar mundësi për të përdorur dhe zhvilluar aftësitë e tyre gjuhësore në situata reale;
- *reflektues* në mënyrën se si ata i përcjellin idetë dhe qëndrimet e tyre kur komunikojnë me të tjerët;
- *novatorë* duke e përdorur gjuhën në situata të njohura dhe të panjohura për ta;
- *të angazhuar* duke përdorur strategji të nxëni që i ndihmojnë ata të shprehin idetë e tyre dhe mënyrën se e të kuptuarit nga ta të kulturave të tjera.

Për më tepër, programi synon të zhvillojë te nxënësit ndërgjegjësimin ndërkulturor dhe aftësinë për të komunikuar me respekt dhe empati në një botë gjithnjë e më globale.

3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i gjuhës së huaj të dytë synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe, duke u mbështetur në situata të jetës reale dhe në kontekstin shkollor. Tematikat në program janë të shumëllojshme (jeta personale e shoqërore, jeta në shkollë e në punë, bota rreth nesh, bota e komunikimit etj.), pasi shkalla e ndërgjegjësimit të nxënësit për domosdoshmërinë e mësimit të gjuhëve të huaja është më e lartë dhe lidhet me problemet e formimit të tij si qytetar bote. Zotërimi i mirë i gjuhëve të huaja ndihmon në zgjerimin e dijeve në fusha të tjera duke kontribuar jo vetëm në krijimin e individualitetit të nxënësit por edhe në ndërtimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve etike që i shërbejnë atij dhe komunitetit.

Programi i lëndës së gjuhës së huaj të dytë në arsimin e mesëm të ulët përmban:

- *Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënës që zhvillohen nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj.* Lënda e gjuhës së huaj kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në forcimin e kompetencave kyçe të nxënësit, duke përmirësuar aftësi si komunikimi, mendimi kritik dhe kreativiteti. Mësimi i gjuhëve të huaja i ndihmon nxënësit të shprehin idetë e tyre qartë dhe të kuptojnë këndvështrime të ndryshme. Nëpërmjet debateve, punës në grup dhe projekteve, ata zhvillojnë dhe forcojnë aftësi sociale dhe emocionale. Gjuha e huaj jo vetëm që mbështet procesin e të nxënës, por gjithashtu përgatit nxënësit për sfidat e së ardhmes.
- *Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj.* Programi i gjuhës së huaj të dytë ndërthur njohuritë dhe aftësitë e saj me temat ndërkurrikulare si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; qytetaria aktive dhe sipërmarrja; shëndeti mendor e fizik dhe siguria; zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore; teknologjia, shoqëria dhe media duke i lidhur konceptet gjuhësore me situata konkrete që nxënësit përballen në jetën e tyre.

Diagrama 1. Përmbajtja e programi lëndor të gjuhës së huaj të dytë



- *Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënit.* Lënda e gjuhës së huaj të dytë synon të pajisë nxënësit me kompetenca që shkojnë përtej njohjes së rregullave gramatikore, duke ju mundësuar atyre të kuptojnë dhe të përdorin gjuhën në mënyrë të saktë dhe të komunikojnë natyrshëm dhe qartë në situata reale. Ky proces i ndihmon nxënësit të kuptojnë kontekstin kulturor dhe shoqëror të komunikimit, dhe i përgatit ata për të përballuar sfidat e së ardhmes në një botë që është gjithmonë në ndryshim.

- *Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit.* Në këtë rubrikë përshkruhet koha e dedikuar (numri i orëve mësimore) në varësi të klasës dhe nivelit gjuhësor, duke ofruar hapësirë për punë individuale, në grup dhe për projekte; veprimtaritë që kryen nxënësi për secilën nga mënyrat e përvetësimit të gjuhës dhe strategjitë për realizimin e tyre, aftësitë gjuhësore, dhe qëndrimet që demonstroi nxënësi. Rubrika përmban edhe shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit në

komunikimin online dhe ndërmjetësimin gjuhësor. Gjithashtu në këtë rubrikë jepen përshkruesit e kompetencës së shumë gjuhësisë dhe shumë kulturave.

- *Metodologjia e mësimdhënies.* Në lëndën e gjuhës së huaj të dytë është e rëndësishme t'i kushtohet një vëmendje e madhe përdorimit të metodave ndërvepruese dhe me në qendër nxënësin, të nxënit bashkëveprues, mësimdhënies së diferencuar, përdorimit të teknologjisë, etj.
- *Vlerësimi i nxënësve.* Në këtë rubrikë përshkruhen në mënyrë të përmblëdhur llojet e vlerësimit të nxënësit, shembuj të instrumenteve të vlerësimit, vlerësimin si metodologji të nxëni. Gjithashtu në këtë rubrikë do të ketë edhe shembuj të vlerësimit të punës me shkrim.

- *Burimet dhe materialet didaktike* që mund të përdoren në lëndën e gjuhës së huaj të dytë janë pjesë e kësaj rubrike. Zbatimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale si mjete ndihmëse trajtohen gjithashtu në program si burime të rëndësishme për zhvillimin e aftësive gjuhësore.
- *Rekomandime për zbatimin e programit.* Në këtë rubrikë jepen disa rekomandime për përdoruesit e programit lëndor siç janë: nxënësit, mësuesit, hartuesit e teksteve mësimore, hartuesit e testeve kombëtare, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit.
- *Ndryshimet përmbajtjesore.* Në këtë rubrikë përshkruhen përditësimet kryesore në përmbajtjen lëndore.

4 KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA

4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës, sipas klasave të arsimit të mesëm të ulët. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive.

Kompetenca kuptohet sot si një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundësojnë nxënësin të përballë me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja e mësimdhënies e bazuar në kompetenca e zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit) drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke u vendosur vetë nxënësi në qendër të procesit. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe që mund të zhvillojë nxënësi në arsimin e mesëm të ulët në lëndën e gjuhës së huaj të dytë mund të përmbledhen si më poshtë:

Tabela 2. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

1	Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare
	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> - komunikon si dëgjues, folës, lexues dhe shkruar në situata të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme; - përdor dhe dallon lloje të ndryshme tekstesh, përfshirë tekstet digjitale; - ndërton identitetin e tij kulturor dhe gjuhësor, si dhe kontribuon në transmetimin dhe pasurimin e trashëgimisë gjuhësore amtare; - përdor gjuhën për të krijuar dhe për të vlerësuar krijime artistike, të cilat shprehin emocionet, përjetimet dhe idetë e tij; - prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup; - përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj;
2	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i> - fillon, ndjek dhe përfundon biseda të thjeshta rreth fushës së tij të interesit; - lexon, kupton dhe prodhon tekste, përfshirë tekstet digjitale të përshtatshme për nevojat e tij; - përdor mjetet në mënyrë të përshtatshme dhe angazhohet me gjuhët në mënyrë informale; - respekton gjuhën amtare të personave që u përkasin minoriteteve; - vlerëson se si ndryshimet kulturore ndikojnë në përdorimin dhe komunikimin e gjuhës; - përshkruan ose prezanton thjeshtë njerëzit, kushtet e jetesës ose punës, rutinën e përditshme; - merr pjesë në bashkëbisedime të thjeshta me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor dhe shoqëror; - prezanton para të tjerëve një projekt të thjeshtë për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup; - përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj si dhe duke përdorur lidhëza të thjeshta;

	- diskuton për një temë të caktuar duke respektuar rregullat e komunikimit; - luan rol mbështetës gjatë një diskutimi kur pjesëmarrësit e tjerë flasin ngadalë dhe e ndihmojnë atë të kontribuojë dhe të shprehë sugjerimet e tij; - identifikon burime informacioni për arsimim dhe orientim profesional, si dhe zhvillon një plan të thjeshtë për zhvillimin e karrierës së tij.
3	Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri
	<i>Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> - komunikon përfundimet dhe arsyetimet që çuan në një përfundim të bazuar në prova; - regjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/faktet për një temë; - shfrytëzon fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje/projekti bazë klase; - parashtron pyetje për çështje të ndryshme dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar; - përzgjedh informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete; - demonstroi zgjidhjen e një problemi bazuar në të dhënat tekstuale, numerike, eksperimentale të detyrës;
4	Kompetenca digjitale
	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> - përdor përmbajtje digjitale; - përdor mjete digjitale për të prodhuar, për të paraqitur dhe për të kuptuar informacione të thjeshta; - përdor teknologjinë digjitale për të krijuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët drejt qëllimeve personale dhe sociale; - përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënës dhe për të rritur efektivitetin në nxënie; - bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur teknologjinë.

5	Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit
	<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:</i> – organizon të nxënit, fokusohet dhe vendos qëllime; – motivon dhe vlerëson veten, mëson dhe punon në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim; – komunikon në mënyrë konstruktive dhe bashkëpunon në ekip; – kupton mënyrën e jetës së shëndetshme, vlerën ushqyese të ushqimeve të cilat konsumon, domosdoshmërinë e kushteve higjienike; – zhvillon aktivitete fizike dhe sportive me karakter krijues apo garues duke u përpjekur në arritjen e rezultateve të caktuara; – dallon sjelljen korrekte nga ajo jo korrekte gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe reagon ndaj sjelljeve negative.
6	Kompetenca qytetare
	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i> - tregon solidaritet dhe interes në zgjidhjen e problemeve në nivel klase dhe shkolle; - vlerëson diversitetet dhe demonstroi tolerancë, mirëkuptim, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve; - demonstroi sjellje etike dhe të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë mjedisore; - solidarizohet me personat në nevojë ose të rrezikuar, duke ndërmarrë veprime konkrete për afrimin e ndihmës sipas nevojës që kanë; - prezanton të kaluarën e familjes, të rrethit shoqëror ose të personaliteteve dhe ngjarjeve kryesore të kombit të vet.
7	Kompetenca e sipërmarrjes
	<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i> - komunikon në mënyrë efektive dhe negocion me të tjerët; - punon në mënyrë të pavarur si dhe bashkëpunon me të tjerët;

	- vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup; - zhvillon një plan për shpenzimet dhe kursimet mujore personale, të familjes ose të klasës; - propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportiv;
8	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i> - njeh, respekton dhe çmon kulturën e tij si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve; - shijon dhe vlerëson veprat e artit; - angazhohet në proceset krijuese individualisht dhe kolektivisht.

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e gjuhës së huaj të dytë

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënës, të cilat ndihmojnë nxënësin të interpretojë botën dhe të lidhë dijet e marra në shkollë me jetën dhe interesat e tij.

Integrimi i temave ndërkurrikulare me gjuhën e huaj në arsimin e mesëm të ulët u mundëson nxënësve të aplikojnë njohuritë e tyre gjuhësore në situata të ndryshme nga jeta reale. Kjo i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të menduarit në mënyrë krijuese dhe kritike duke i inkurajuar ata të eksplorojnë më tej botën që i rrethon. Përdorimi i gjuhëve të huaja si një mjet komunikimi dhe shprehjeje, zhvillon tek nxënësit aftësi të rëndësishme të cilat ndihmojnë në përshtatjen me tregun e punës dhe jetën e përditshme. Kjo qasje gjithashtu rrit motivimin dhe angazhimin e nxënësve si qytetarë aktivë në shoqëri.

- *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.* Gjuha e huaj i ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë historinë dhe kulturën e vendeve të ndryshme, duke krijuar një lidhje me identitetin e tyre kombëtar. Në orën e mësimi të gjuhës së huaj të dytë, nxënësit nëpërmjet projekteve të ndryshme

diskutojnë mbi tradita, zakone dhe vlera nga kultura e vendit të tyre dhe vendeve dhe popujve të tjerë, duke nxitur mirëkuptimin dhe respektin për diversitetin kulturor.

- *Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.* Në orën e gjuhës së huaj të dytë, nxënësit mund të diskutojnë thjeshtë mbi rëndësinë e të qenit qytetar aktiv në shoqëri, të flasin për jetën e sipërmarrësve të suksesshëm, etj. Gjithashtu, nxënësit mund të organizojnë lojë me role si krijimi i një tregu të vogël në klasë, organizimi i një aktiviteti vullnetar në komunitet, ose të punojnë me projekte për hartimin e një plani të thjeshtë biznesi, organizimin e një fushate ndërgjegjëse për problemet që shqetësojnë komunitetin, etj.
- *Shëndeti mendor, fizik dhe siguria.* Gjuha e huaj jo vetëm që ndihmon në promovimin e shëndetit mendor, fizik dhe siguri së përmes informimit dhe komunikimit efektiv, por ajo shërben edhe si një mjet për të rritur vetëdijen dhe për t'u angazhuar në diskutime të rëndësishme për shëndetin. Nxënësit mësojnë të lexojnë dhe interpretojnë materiale informative, si artikuj dhe broshura, që lidhen me shëndetin dhe mirëqenien. Gjatë diskutimeve mbi tema si stresi, ushqimi i shëndetshëm dhe praktikat e siguri së, nxënësit zhvillojnë aftësi për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre.
- *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.* Gjuha e huaj e dytë nëpërmjet teksteve informuese promovon zhvillimin e qëndrueshëm dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Nxënësit mësojnë të lexojnë dhe interpretojnë materiale mbi temat si energjia e rinovueshme, mbetjet dhe ndryshimet klimatike, etj.
- *Teknologjia, shoqëria dhe media.* Gjuha e huaj ndihmon nxënësit të përpunojnë dhe interpretojnë informacionin digjital si dhe të kuptojnë sa më mirë marrëdhënien mes teknologjisë, shoqërisë dhe medias. Duke lexuar dhe analizuar artikuj, postime në rrjetet sociale dhe burime të tjera, nxënësit zhvillojnë aftësi për të identifikuar dhe diskutuar ndikimin që ka media në shoqëri.

Veprimtaritë praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare mund të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

4.3 Kompetencat e lëndës së gjuhës së huaj të dytë dhe rezultatet e të nxënit

Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaj është një sintezë e njohurive të parimeve bazë gramatikore, të përdorimit të funksioneve gjuhësore në situata të ndryshme komunikimi dhe lidhjes së tyre me parimet e ligjëritimit.




Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së gjuhës së huaj

Bazuar në kurrikulën e arsimit të mesëm të ulët, lënda e gjuhës së huaj synon të përmbushë 3 kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe arrihen nëpërmjet veprimtarive gjuhësore që kryen nxënësi për përmbushjen e detyrave të caktuara. Këto kompetenca zbërthehen në rezultate të nxëni për secilën klasë.

Përshkrimi i kompetencave të lëndës

Kompetenca e komunikimit gjuhësor përbëhet nga kompetencat e mëposhtme:

- a) Kompetenca gjuhësore** nënkupton përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike si dhe pasurimin e fjalorit.
- b) Kompetenca socio-gjuhësore** ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjërimit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore. Këto kontekste kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit si dhe me faktorë të tjerë që influencojnë në stilin dhe regjistrat e gjuhës. Zhvillimi i kësaj kompetence është shumë i rëndësishëm pasi në situata të ndryshme duhen përdorur lloje të ndryshme shprehjesh si edhe duhen mbajtur qëndrime, besime, vlera dhe pikëpamje të ndryshme.
- c) Kompetenca pragmatike** ka të bëjë me njohjen e rregullave dhe parimeve sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturorët (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizimin e funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rënia dakord, përshëndetjet etj).

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës për gjuhën frënge gjenden në aneksin 1, tabela 1.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës për gjuhën italiane gjenden në aneksin 2, tabela 1.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave për të lëndës gjuhën gjermane gjenden në aneksin 3, tabela 1.

5 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1 Koha mësimore për klasën e gjashtë dhe të shtatë

Lënda e gjuhës së huaj të dytë në klasën e gjashtë dhe të shtatë zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 2 orë secila (45 min), pra gjithsej 70 orë. Programi i gjuhës së huaj të dytë specifikon peshën (orët e sugjeruara) për secilin komponent mësimor. Shuma e orëve sugjeruese për secilin komponent është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët. Shpërndarja e orëve ka për qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secili komponent në raport me orët totale vjetore.

Tabela 3: Orë të sugjeruara klasa e gjashtë

	Formimi kulturor dhe ndërkulturor	Formimi gjuhësor		Projekti dhe puna me Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		
Klasa e VI	30 orë	20 orë	12 orë	8 orë	70 orë

Tabela 3: Orë të sugjeruara klasa e shtatë

	Formimi kulturor dhe ndërkulturor	Formimi gjuhësor		Projekti dhe puna me Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		
Klasa e VII	30 orë	20 orë	12 orë	8 orë	70 orë

- Në orët e formimit kulturor përfshihen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.
- Orët e formimit gjuhësor mbi gramatikën përfshijnë njohuritë gramatikore dhe punën me fjalorin që realizohet gjatë vitit. Këtu mund të përfshihen edhe orët e e përsëritjes, përforcimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme dhe të testeve. Gjithashtu njohuritë gramatikore nuk mund të merren jashtë kontekstit dhe duke pasur parasysh që përqasja në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënës, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit.

Funksionet gjuhësore ju referohen akteve të komunikimit që nxënësi realizon gjatë procesit të marrjes së gjuhës së huaj dhe mund të realizohen në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e tjera.

Planifikimi i orëve të punës me Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ) në lëndën e gjuhës së huaj të dytë ndihmon nxënësin të identifikojnë dhe vlerësojnë arritjet e tij gjuhësore në mënyrë sistematike nëpërmjet një strukture të qartë për zhvillimin e aftësive dhe përmirësimin e kompetencave,

dhe e inkurajuar atë të jetë i pavarur në përvetësimin e gjuhës. Mësuesi planifikon veprimtari me PEGJ për ditën Evropiane të gjuhëve të huaja si dhe gjatë orëve të projektit.

5.2 Përmbajtja e klasës së gjashtë dhe të shtatë

Përqasja e adoptuar nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) është e orientuar drejt veprimit ku nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d.m.th. pjesëtar i shoqërisë i cili ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi.

Përdorimi i gjuhës së huaj, duke përfshirë edhe të nxënit e saj, përfshin veprimtari që kryen nxënësi, i cili si individ dhe si pjesëtar i shoqërisë zhvillon kompetencat kyçe dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. Gjatë këtij procesi, nxënësi përdor kompetencat kyçe në situata dhe kushte të ndryshme, përfshihet në veprimtari gjuhësore të shumëllojshme duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhet të realizojë. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi çon në përforcimin ose përmirësimin e kompetencave kyçe. Kjo përqasje ilustron në figurën e mëposhtme.

Diagrama 2: Të mësuarit dhe përdorimi i gjuhës së huaj



Njohuri dhe koncepte

Njohuritë dhe konceptet kryesore që trajtohen në lëndën e gjuhës së huaj të dytë mund të jenë shumë të ndryshme, por për qëllime praktike në lidhje me të nxënit dhe mësimdhënien e gjuhëve, ato mund të klasifikohen gjerësisht në katër fusha kryesore: (a) fusha personale, (b) fusha publike, (c) fusha arsimore -edukative dhe (d) fusha profesionale të cilat ndahen në nën tema.

Temat dhe nën temat, njohuritë gramatikore dhe funksionet gjuhësore të cilat mund të trajtohen në klasën e gjashtë dhe të shtatë në gjuhën frënge gjenden në aneksin 1, tabela 2.

Temat dhe nën temat, njohuritë gramatikore dhe funksionet gjuhësore të cilat mund të trajtohen në klasën e gjashtë dhe të shtatë në gjuhën italiane gjenden në aneksin 2, tabela 2.

Temat dhe nën temat, njohuritë gramatikore dhe funksionet gjuhësore të cilat mund të trajtohen në klasën e gjashtë dhe të shtatë në gjuhën gjermane gjenden në aneksin 3, tabela 2.

5.3 Veprimtari gjuhësore

Për të përmbushur rezultatet e të nxënit dhe për të forcuar kompetencat e lëndës së gjuhës së huaj të dytë dhe aftësitë e të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, nxënësi kryen veprimtaritë gjuhësore të mëposhtme:

- a) **Veprimtari marrëse** (të lexuarit, të dëgjuarit)
- b) **Veprimtari prodhuese** (të folurit, të shkruarit)
- c) **Veprimtari ndërvepruese** (të folurit, të shkruarit)
- d) **Veprimtari ndërmjetësimi** (ndërmjetësimi gjuhësor dhe kulturor).

Lidhja midis aftësive, shkathtësive, veprimtarive gjuhësore dhe kompetencave mund të shihet si një lidhje burimore ku nxënësi gjen tek kompetencat mjetet për të realizuar veprimtaritë, por këto të fundit modifikohen dhe shtohen gjatë procesit të komunikimit.

Përdorimi i gjuhës veçanërisht në ndërveprim me të tjerët lejon përvetësimin e gjuhës, e cila në vetvete përfshin zhvillimin e kompetencave. Të mësuarit e pa kontekstualizuar të kompetencave (si p.sh mësimi i rregullave gramatikore) e ndihmon nxënësin, por nuk është i mjaftueshëm për të përdorur gjuhën si një mjet komunikimi. Përshkrimi i detajuar i veprimtarive të mëposhtme ndihmon mësuesin për të përcaktuar rezultatet e të nxënit për orën mësimore.

a) Veprimtari marrëse

Marrja e informacionit përfshin të kuptuarin dhe përpunimin e të dhënave në situata të ndryshme kur nxënësi e dëgjon, e lexon ose e shikon një informacion të caktuar si për shembull: dëgjimi i njoftimeve publike, informimi (media), të qenit spektator (kinema, teatër, mbledhje publike,

konferenca, shfaqje), leximi për t'u orientuar, për t'u informuar ose për të ndjekur udhëzime, leximi për kënaqësi, etj. Si kur dëgjon ashtu edhe ku lexon nxënësi punon për të kuptuar informacionin duke kaluar nga aspektet më të thjeshta (identifikimi i titullit, përcaktimi i temës, kuptimi i përgjithshëm dhe deshifrimi i situatës së komunikimit, kërkimi i një informacioni specifik, për shembull mbi një personazh, marrja e detajeve) drejt përpunimit të informacioneve më komplekse (lidhja midis informacioneve të ndryshme, leximi i mesazheve të nënkuptuara, etj.) sipas nivelit të kompetencës që synohet.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi për marrjen e informacionit të shpjeguar në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën frënge gjenden në aneksin 1, tabela 3.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi për marrjen e informacionit të shpjeguar në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën italiane gjenden në aneksin 2, tabela 3.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi për marrjen e informacionit të shpjeguar në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën gjermane gjenden në aneksin 3, tabela 3.

b) Veprimtari prodhuese

Veprimtaritë prodhuese përfshijnë detyrat që realizon nxënësi me gojë dhe me shkrim. Nxënësi realizon detyra me gojë si për shembull bën njoftime publike reale ose imagjinare, lexon një tekst të përgatitur me zë të lartë, këndon një këngë, prezanton një detyrë, komenton një ngjarje, mbron një pikëpamje të tij, etj. Nxënësi gjithashtu realizon detyra me shkrim si për shembull plotëson një pyetësor, shkruan një artikull për shtyp, krijon një poster, përpilon një listë, harton një raport, përmbledh një artikull, shkruan një e-mail-e, tregim, ese, etj.

Të gjitha detyrat që realizon nxënësi si me shkrim apo me gojë duhet të jenë pjesë e një situatë komunikimi nga jeta reale që justifikon përdorimin e gjuhës së huaj.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi kur prodhon informacion të shpjeguar në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën frënge gjenden në aneksin 1, tabela 4.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi kur prodhon informacion të shpjeguar në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën italiane gjenden në aneksin 2, tabela 4.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi kur prodhon informacion të shpjeguar në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën gjermane gjenden në aneksin 3, tabela 4.

c) Veprimtari ndërvepruese

Nxënësi e mëson dhe e përdor më mirë gjuhën e huaj kur ai vendoset në situata ndërveprimi ku shkëmben ide me një ose më shumë bashkëbisedues. Ndërveprimi me gojë zhvillohet kryesisht në formën e diskutimeve formale ose informale, debateve, intervistave, bisedave, etj. Ndërveprimi me shkrim po merr gjithnjë e më shumë rëndësi në jetën e përditshme si pasojë e zhvillimit të rrjeteve sociale dhe mjeteve të lëvizshme të komunikimit: e-mail, mesazhe SMS, postime në Twitter, forume diskutimesh, shkrime bashkëpunuese të teksteve online, etj.

Që të jetë efektiv, ndërveprimi duhet t'i afrohet sa më shumë situatave autentike dhe të ngjashme me jetën reale, ku shkëmbimi i informacionit tashmë është një nevojë për secilin nga ne.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi kur ndërvepron me të tjerët të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën frënge gjenden në aneksin 1, tabela 5.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi kur ndërvepron me të tjerët të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën italiane gjenden në aneksin 2, tabela 5.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi kur ndërvepron me të tjerët të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën gjermane gjenden në aneksin 3, tabela 5.

d) Veprimtari ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi gjuhësor sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian për Gjuhët dhe Volumit Shoqërues, ka të bëjë me mënyrën se si nxënësi ja shpjegon një material të cilin ai ka lexuar ose dëgjuar dikujt që nuk mund ta kuptojë atë material. Ndërmjetësimi gjuhësor përfshin një sërë veprimtarish që variojnë nga perifrazimi e deri te përkthimi. Ndërmjetësimi e vendos nxënësin në një situatë ku ai vlerëson të gjithë njohuritë dhe aftësitë e tij. Në të dyja format, atë me gojë dhe atë me shkrim, nxënësi ndërmjetësues:

- merr shënime, perifrazon ose bën përmbledhjen e një materiali për shokët e klasës;
- identifikon elementet kulturore që janë të pakuptueshme për të tjerët dhe i bën ato të kuptueshme;
- përkthen një tekst të shkruar, ose realizon një dublim filmi për të tjerët;
- udhëheq një punë kolektive, lehtëson bashkëpunimin, kontribuon në shkëmbime ndërkulturore, etj.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi gjatë ndërmjetësimit gjuhësor të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën frënge gjenden në aneksin 1, tabela 6.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi gjatë ndërmjetësimit gjuhësor të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën italiane gjenden në aneksin 2, tabela 6.

Veprimtaritë që zhvillon nxënësi gjatë ndërmjetësimit gjuhësor të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënit në gjuhën gjermane gjenden në aneksin 3, tabela 6.

5.4 Strategji komunikimi

Për të kryer detyrat që i jepen nxënësi duhet të përfshihet në veprimtari të shumta gjuhësore dhe të përdorë strategji komunikimi. Strategjitë që përdor nxënësi për të komunikuar konsiderohen si nyje lidhëse midis burimeve të nxënësit (kompetencat) dhe se çfarë ai mund të bëjë me ato

(veprimtaritë komunikuese). Shumica e situatave përfshijnë llojshmëri veprimtarish dhe përdorim të më shumë se një aftësie ose shkathtësie. Strategjitë janë mjeti që nxënësi përdor për të mobilizuar dhe balancuar të gjitha burimet e tij, të aktivizojë të gjitha aftësitë e tij për të përmbushur plotësisht dhe me sukses detyrat që i jepen.

Strategjitë që përdor nxënësi të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënës në gjuhën frënge gjenden në aneksin 1, tabela 7.

Strategjitë që përdor nxënësi të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënës në gjuhën italiane gjenden në aneksin 2, tabela 7.

Strategjitë që përdor nxënësi të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënës në gjuhën gjermane gjenden në aneksin 3, tabela 7.

5.5 Kompetenca shumë gjuhësore dhe shumë kulturore

Programi i lëndës së gjuhës së huaj të dytë inkurajon të mësuarin e shumë gjuhëve dhe njohjen e shumë kulturave si faktorë që ndihmojnë nxënësin të zhvillojë kompetencën e komunikimit në gjuhë amtare dhe gjuhë të huaj. Kjo qasje thekson faktin se përvoja e nxënësit me gjuhët në kontekstet e tij kulturore zgjerohet, nga gjuha amtare

në atë të shoqërisë në përgjithësi dhe më pas në gjuhët e popujve të tjerë (qoftë të mësuara në shkollë, apo nga përvoja të ndryshme në jetë). Nxënësi nuk i mban këto gjuhë dhe kultura të ndara, por përkundrazi ndërton një kompetencë komunikuese në të cilën kontribuojnë të gjitha njohuritë dhe përvojat gjuhësore dhe në të cilën gjuhët ndërliken dhe bashkëveprojnë. Në situata të ndryshme, nxënësi përdor pjesë të ndryshme të kësaj kompetence për të arritur komunikim efektiv me një bashkëbisedues të caktuar. Kjo qasje gjithashtu thekson rëndësinë që ka njohja e gjuhëve të tjera dhe kulturave të ndryshme duke ndihmuar nxënësin të kuptojë dhe të respektojë diversitetin gjuhësor dhe kulturor. Në këtë mënyrë, nxënësi zhvillon aftësi për të komunikuar në një shoqëri gjithnjë e më ndryshme dhe ndihmon që kjo shoqëri të jetë më tolerante dhe më e hapur. Integrimi i elementeve kulturore në mësimdhënie e inkurajon nxënësin të njihet me këndvështrime të ndryshme dhe gjithashtu të forcojë identitetin e tij kulturor, duke u bërë një qytetar më i angazhuar dhe i vetëdijshëm në shoqëri.

Nxënësi reflekton dhe dokumenton në Portofoli Evropian i Gjuhëve (ELP) përvoja të larmishme ndërkulturore të cilat e ndihmojnë në të nxënës e gjuhëve të huaja.

5.6 Qëndrime dhe vlera

Në lëndën e gjuhës së huaj të dytë nxënësi demonstroi qëndrimet dhe vlerat të përmbledhura si më poshtë:

Nxënësi:

- demonstroi pavarësi dhe është i paanshëm në marrjen e vendimeve kryerjen e veprimeve të tij;
- demonstroi besim dhe vullnet në punën dhe përpjekjet e ti për arritjen e rezultateve;
- respektoi përpjekjet personale dhe ato në grup duke treguar gatishmëri për të bashkëpunuar;
- ndjek më vëmendje shokët kur flasin dhe respektoi radhën e të folurit;
- përzgjedh fjalorin e duhur (nuk fyen, përdor fjalët e mirësjelljes etj) dhe tregon empati gjatë komunikimit me shokët e klasës;
- tregon interes në materialet që lexon dhe vlerëson burime të ndryshme informacioni;
- respektoi bashkëfolësit pa dallime gjinie, besimi, ideje;
- demonstroi bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup dhe në diskutime;
- mban qëndrimin e tij ndaj problemeve që dalin në klasë dhe në shkollë;
- merr pjesë në diskutime duke respektuar dhe pranuar mendimin ndryshe;
- vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre;
- njeh, respektoi dhe pranon diversitetin gjuhësor dhe kulturor;
- është i ndërgjegjshëm për ndikimin e teknologjisë në gjuhë dhe komunikim.
- është i ndërgjegjshëm për kontributin e gjuhëve në zhvillimin e mendimit kritik.

5.7 Formimi kulturor dhe ndërkulturor

Mësimi i gjuhëve të huaja ka si objektiv kryesor sigurimin e komunikimit mes folësve të kulturave ku fliten këto gjuhë. Pavarësisht këtij funksioni fillestar, i cili është i rëndësishëm, komunikimi ndërgjuhësor ka një dimension më të thellë: njohjen e kulturës dhe historisë që përmbajnë gjuhët e huaja që nxënësi mëson. Ky dimension i mësimi të gjuhës së huaj, që lidhet me komunikimin dhe kulturën, hedh bazat në arsimin e mesëm të ulët dhe forcohet në arsimin e mesëm të lartë.

Në arsimin e mesëm të ulët, nxënësi fillon të eksplorojë lidhjen kulturore që kanë gjuhët. Gjuhët e huaja i mundësojnë nxënësit të kuptojë një univers të ri, të përballet me një botë që është më shumë ose më pak e largët nga universi i tij i zakonshëm dhe të gjejë, në dallimin dhe ndryshimin nga kultura e tij, një pasurim që do ta formojë gjatë gjithë jetës së tij. Dimensioni kulturor, i domosdoshëm për dialogun shoqëror, shënon një hap të rëndësishëm për nxënësin pasi ai zgjeruan horizontin e tij kulturor dhe shoqëror me një nivel më të lartë autonomie. Arsimi i mesëm i ulët ofron mundësi të ndryshme për nxënësit në pasurimin e përvojave për të komunikuar – lojë me role, simulime, komunikim me bashkëmoshatarë nga vende të tjera, projekte ndërkurrikulare dhe temat globale, aktivitete jashtëshkollore – të cilat janë faktorë të favorshëm për krijimin e marrëdhënieve të ndryshme njerëzore. Për më tepër, zhvillimi i rrjeteve digjitale shtohet në këtë realitet të ri.

5.8 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).

Për një planifikim sa më të mirë të orës së mësimi në përmbushje të rezultateve të të nxënit programi përfshin shembuj nga fusha të ndryshme tematike. Në anekset përkatëse për secilën gjuhë paraqiten shembuj të veprimtarive të cilat planifikon mësuesi në përmbushje të rezultateve të të nxënit. Shembujt e dhënë fokusohen në rezultatet e të nxënit të komunikimit online dhe ndërmjetësimi gjuhësor dhe kulturor. Gjithashtu në këtë rubrikë jepen shembuj se si lidhen kompetencat e lëndës me strategjitë përkatëse për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve dhe të lidhjes së kompetencave të lëndës me strategjitë e të nxënit në gjuhën frënge gjenden në aneksin 1 tabelat 8,9.

Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve dhe të lidhjes së kompetencave të lëndës me strategjitë e të nxënit në gjuhën italiane gjenden në aneksin 2, tabelat 8,9.

Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve dhe të lidhjes së kompetencave të lëndës me strategjitë e të nxënit në gjuhën gjermane gjenden në aneksin 1 tabelat 8,9.

6 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

6.1 Qasja e orientuar drejt veprimit

Metodologjia bazë në mësimdhënien e gjuhës së huaj bazohet në qasjen e orientuar drejt veprimit e cila ka në fokus aftësimin e nxënësit për të vepruar dhe shprehur në situata të ndryshme nga jeta reale. Në këtë qasje, nxënësi paraqitet si një pjesëtar i shoqërisë duke promovuar së pari autonominë dhe përfshirjen e tij në procesin e të nxënës.

Bazuar në këtë qasje programi i gjuhës së huaj të dytë nuk është një program linear i strukturave gjuhësore, ose një grup njohurish dhe funksionesh gjuhësore, por është një program i bazuara në analizën e nevojave të nxënësit, të orientuara drejt detyrave të jetës reale dhe të ndërtuara rreth nocioneve dhe funksioneve gjuhësore të zgjedhura për këtë qëllim. Kjo promovon një perspektivë ku merren në konsideratë aftësitë se çfarë është në gjendje të bëjë nxënësi. Gjithashtu mësuesi planifikon duke filluar nga nevojat që ka nxënësit për të komunikuar në një botë reale dhe më pas i përshtat ato me rezultatet e të nxënës dhe mënyrën e vlerësimit (backward planning/design).

Kur nxënësi konsiderohet si një pjesëtar i shoqërisë në përdorimin e gjuhës, ai përfshihet në procesin e të nxënës duke njohur më mirë natyrën sociale të gjuhës dhe përdorimin e saj në vend që thjesht të mësojë rreth gjuhës si një lëndë mësimore. Qasja e orientuar drejt veprimit e merr në konsideratë gjithashtu kompetencën shumë gjuhësore dhe shumë kulturave, duke i mundësuar nxënësit të përdorë të gjitha burimet e tij gjuhësore kur është e nevojshme, duke e inkurajuar ata të shohë dhe dallimet midis gjuhëve dhe kulturave.

Metodologjitë e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive të orientuar drejt veprimit.

Mësuesit e gjuhës së huaj, duke mos lënë mënjanë metodat tradicionale të mësimdhënies, duhet të përdorin gjerësisht metodën komunikuese në mësimdhënie. Qëllimi i kësaj metode është që në orën e mësimi gjuha e përdorur të jetë sa më afër gjuhës që përdoret në jetën e përditshme. Kjo do të thotë që mësuesi duhet t'i mësojë nxënësit jo “si të flasin” por “çfarë të flasin” dhe “kur të flasin”.

1. Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit janë në qendër të procesit të mësimdhënies i cili ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm dhe kanë stile të ndryshme për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Shembuj të mësimdhënies me në qendër nxënësin përfshijnë diskutimin, lojërat, simulimet, zbulimin dhe zgjidhjen e problemeve.

2. Të nxënit bashkëveprues

Të nxënit bashkëveprues është një metodë e mësimdhënies dhe të nxënit, ku nxënësit bashkohen për të eksploruar më tej konceptet e mësuara, për të krijuar projekte të ndryshme. Të mësuarit bashkëveprues ndihmon në zhvillimin e aftësive të komunikimit, zhvillon aftësitë sociale të nxënësve, promovon vetëvlerësimin e tyre dhe i bën ata nxënës autonomë.

3. Mësimdhënia e diferencuar

Mësimdhënia e diferencuar ndihmon mësuesit të angazhojnë në orën e mësimit çdo nxënës duke ju përshtatur stilit të tyre specifik të të nxënit. Mësimdhënia e diferencuar ofron një mënyrë për të përmbushur të gjitha nevojat e nxënësve duke i inkurajuar ata të shprehin atë që kanë mësuar në mënyra të ndryshme.

4. Integrimi i aftësive gjuhësore

Të katër aftësitë gjuhësore (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit) duhet të integrohen tërësisht në mësimdhënien dhe të nxënit e gjuhës së huaj. Kjo metodologji holistike pasqyron natyrën komplekse të përdorimit të gjuhës në jetën reale dhe i përgatit më mirë nxënësit për komunikim efektiv në kontekste të ndryshme.

5. Përdorimi i teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale (IA)

Kjo metodologji përdor teknologjinë dhe inteligjencën artificiale për të krijuar përvoja të personalizuar dhe ndërvepruese të të nxënit. Përfshirja e teknologjisë dhe IA në metodologjitë e mësimi të gjuhës së huaj ofron një përvojë dinamike, të personalizuar dhe tërheqëse dhe përgatit më mirë nxënësit për komunikim në botën reale në gjuhën e huaj që po mësojnë.

6. Të nxënit bazuar në projekt

Të nxënit bazuar në projekt përfshin një qasje dinamike në klasë dhe një metodë mësimdhënieje përmes së cilës nxënësit fitojnë njohuri më të thellë duke eksploruar aktivisht sfidat dhe problemet e botës reale. Të nxënit bazuar në projekt krijon praktika të reja mësimore, të cilat pasqyrojnë mjedisin aktual ku nxënësit jetojnë dhe mësojnë, vendos kërkesa të reja për nxënësit dhe mësuesit për të sfiduar praktikat tradicionale në mësimin e gjuhëve të huaja.

7. Të nxënit bazuar në detyra

Mësuesi organizon mësimin rreth detyrave që nxënësit kryejnë duke përdorur gjuhën e huaj që po mësojnë. Këto detyra imitojnë aktivitetet e botës reale dhe kërkojnë që nxënësit të përdorin komunikim autentik. Fokusi është në arritjen e rezultateve të të nxënit përmes përdorimit të gjuhës, gjë që i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre gjuhësore në mënyrë natyrale.

8. Të nxënit social dhe emocional

Kjo metodologji gërsheton parimet e të nxënit social dhe emocional (vetëdija, vetë-menaxhimi, ndërgjegjësimi social, aftësitë e marrëdhënieve dhe vendimmarrja e përgjegjshme) në të nxënit e gjuhëve të huaja, duke theksuar zhvillimin e inteligjencës emocionale të nxënësve krahas aftësive gjuhësore. Mësuesit krijojnë një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës ku nxënësit ndihen të sigurt kur përballen me, duke shprehur ndjenjat e tyre dhe duke mbështetur njëri-tjetrin.

9. Qëndrueshmëria mjedisore

Kjo metodologji i inkurajuar nxënësit të ndërveprojnë me mjedisin e tyre dhe ta përdorin gjuhën në mënyra autentike dhe kuptimplote. Përfshirja në orën e mësimin të ndryshimeve klimatike dhe çështjeve të tjera globale me të cilat po përballet shoqëria e bën mësimin e gjuhës së huaj më tërheqës, praktik dhe efektiv.

10. Edukimi për Median dhe Informacionin (EMI)

Edukimi për median dhe informacionin është një metodologji që ndërthur mësimin e aftësive gjuhësore me zhvillimin e të menduarit kritik, vlerësimin e informacionit dhe konsumin e përgjegjshëm të medias. Integrimi i EMI në mësimdhënien e gjuhës së huaj krijon një mjedis mësimor dinamik që përgatit nxënësit për komunikim efektiv dhe pjesëmarrje aktive në shoqërinë e një epoke digjitale.

11. Integrimi i qasjes STEAM (Science, Technology, Engineering, the Arts and Mathematics)

Nxënësi harton projekte ose detyra duke vënë në përdorim njohuritë e marra në matematikë, në lëndët shkencore dhe në art. Kjo qasje ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e shekullit 21 si bashkëpunimi, krijimtaria, dhe të menduarit kritik.

6.2 Roli i situatave praktike në mësimin e gjuhës së huaj

Një ndër mënyrat më efektive për të ndërtuar kuptim të qëndrueshëm dhe të thelluar të njohurive dhe koncepteve gjuhësore në arsimin e mesëm të ulët është përfshirja e situatave reale dhe praktike në procesin e të nxënës. Situatat e të nxënës në lëndën e gjuhës së huaj mund të zgjasin një ose disa orë mësimi. Këto situata ndihmojnë që nxënësi t'i përdorë njohuritë e marra në jetën e tij të përditshme pa vështirësi dhe në interes të tij. Mësimi nëpërmjet situatave reale, si biseda në dyqan, diskutime në klube, ose aktivitete shoqërore, i bën nxënësit të ndihen më të angazhuar dhe të motivuar në orën e mësimin. Duke u përfshirë në situata nga jeta reale nxënësit përmirësojnë aftësinë e të dëgjuarit dhe të folurit. Përballja me sfida reale i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre të mendimit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve, duke i përgatitur ata më mirë për situata të ndryshme në jetë. Pavarësisht metodave të përdorura mësuesi duhet të ketë parasysh që nxënësi ka fituar:

- kompetencat e duhura;
- aftësinë për t'i përdorur këto kompetenca;
- aftësinë për të përdorur strategjitë e duhura në vënien e kompetencave në veprim.

6.3 Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjuhës së huaj

Projektet kurrikulare përbëjnë një komponent të rëndësishëm të procesit mësimor në lëndën e gjuhës së huaj të dytë në arsimin e mesëm të ulët, pasi ato i japin mundësi nxënësve të zbatojnë njohuritë e fituara në mënyrë të pavarur, funksionale dhe krijuese, përtej detyrave standarde të tekstit shkollor. Projektet kurrikulare inkurajojnë nxënësit të praktikojnë aftësitë gjuhësore dhe të shprehin qartë idetë e tyre. Angazhimi në projekte i motivon nxënësit të jenë aktivë në procesin e të nxënës dhe të bashkëpunojnë me njeri tjetrin duke zhvilluar aftësitë e tyre sociale, mendimin kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve. Gjithashtu projektet kurrikulare përfshijnë elemente kulturore, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë kulturën e vendeve ku flitet gjuha e huaj që ata po mësojnë dhe të forcojnë ndjenjën e respektit për diversitetin kulturor. Projektet mund të ndërtohen rreth temave që lidhen drejtpërdrejt me jetën e përditshme ku nxënësit zgjidhin probleme reale dhe marrin vendime të përgjegjshme.

Në këtë proces, roli i mësuesit është ai i *udhëheqësit/organizuesit dhe mentorit*, duke i ndihmuar nxënësit që:

- të formulojnë pyetje hulumtuese,
- të planifikojnë hapat e punës,
- të mbledhin dhe të analizojnë të dhëna,
- të interpretojnë rezultatet,
- të prezantojnë në mënyrë të qartë përfundimet e tyre.

Projektet gjithashtu ofrojnë mundësi për integrim ndërdisiplinor, duke lidhur gjuhën e huaj me matematikën, me shkencën, teknologjinë, ekonominë, gjeografinë apo edukimin qytetar, duke i përgatitur nxënësit për sfida reale që kërkojnë mendim kompleks dhe bashkëpunim.

6.4 Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)

Portofoli Evropian të Gjuhëve (PEGJ), i akredituar nga Këshilli i Evropës për t'u përdorur si dokument kurrikular, është hartuar për tre qëllime kryesore:

- a. të mbështesë dhe të zhvillojë autonominë e nxënësit;
- b. të forcojë ndërgjegjësimin ndërkulturor të nxënësit;
- c. të promovojë plurilingualizmin.

PEGJ ka dy funksione:

- a. **Raportues**- tregon aftësitë e nxënësit në lidhje me gjuhët e huaja që ai di ose po mëson duke dhënë informacion rreth përvojave dhe shembuj konkretë mbi arritjet e tij në këto gjuhë. Rëndësia e funksionit raportues të PEGJ-it ndryshon sipas moshës së nxënësit.
- b. **Pedagogjik**- PEGJ është hartuar me synimin e bërjes transparent të procesit të të nxënit të gjuhëve, duke ndihmuar nxënësin të zhvillojë kapacitetin për reflektim dhe vetëvlerësim. Ky funksion përkon me synimet e Këshillit të Evropës për forcimin dhe zhvillimin e autonomisë të nxënësit.

Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ) përbëhet nga tri pjesë:

1. **Pasaporta Gjuhësore**
2. **Biografia Gjuhësore**
3. **Dosja**

Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit të cilat nxënësi i për zgjedh bazuar në përshkruesit e Biografisë Gjuhësore tek PEGJ për një aftësi të caktuar (të lexuarit, të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit) dhe nivelit përkatës. Detyrat duhet të përfshijnë të gjitha aftësitë e gjuhës (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit).

Duke qenë një dokument kurrikular mësuesi duhet të planifikojë veprimtari të larmishme që nxënësi të punojë me këtë dokument si p.sh.: punë në grup, punë në çift, ushtrime të krijuara nga nxënësit, diskutime etj. (orët e PEGJ planifikohen brenda orëve të projektit).

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës së huaj do të përshkruhen veprimtari praktike për përdorimin e PEGJ në klasë.

6.5 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjuhës së huaj

Në mësimin e gjuhës së huaj, është e rëndësishme që të gjithë nxënësit të ndihen të përfshirë. Disa nxënës mund të përballen me sfida që lidhen me të kuptuarit e koncepteve abstrakte, me ritmin e të mësuarit ose me aftësitë për të zbatuar njohuritë. Roli i mësuesit është të ofrojë mbështetje të personalizuar dhe të krijojë mjedise që nxisin zhvillimin e këtyre aftësive, duke përdorur qasje të ndryshme si:

- ofrimi i ushtrimeve të përshtatura dhe graduale që përforcojnë kuptimin bazë të koncepteve gjuhësore;
- përdorimi i mjeteve konkrete, ilustrimeve, skemave, vizualizimeve dhe simulimeve digjitale që ndihmojnë nxënësit të lidhin njohuritë gjuhësore me përvojën konkrete;
- organizimi i punës në grupe të vogla ose në çift, duke inkurajuar ndihmën dhe shkëmbimin e ideve mes nxënësve;
- ofrimi i udhëzimeve të qarta dhe strukturimit të pyetjeve që nxisin të menduarit hap pas hapi;
- përdorimi i teknologjisë arsimore (aplikacione, platforma, video mësimore) që ofrojnë mundësi të ndryshme për t'u praktikuar.

6.6 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës së huaj

Nxënësit që tregojnë interes të shtuar në lëndën e gjuhës së huaj shpesh kanë nevojë për detyra dhe sfida që i ndihmojnë të thellojnë të kuptuarit, të zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues, si dhe të zbatojnë njohuritë në mënyrë fleksibël në situata të reja. Mësuesi ka rolin e udhëheqësit dhe motivuesit, duke i inkurajuar këta nxënës:

- të përballen me detyra të hapura, kërkojnë analiza të thelluara, krahasime, përgjithësime, argumentim, etj.;
- të krijojnë vetë situata problemore, skenarë ose pyetje që nxisin zgjidhje kreative dhe të argumentuara;
- të marrin pjesë në diskutime, debate ose analiza mbi tematika dhe probleme aktuale për të shprehur dhe mbrojtur idetë e tyre;
- të angazhohen në lojëra logjike, sfida mendore, ose ushtrime që stimulojnë mendimin deduktiv dhe aftësitë analitike;
- të marrin pjesë në simulime të Model UN, konkurse debatesh, esesh, etj.

7 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në mësimin e gjuhës së huaj të dytë, vlerësimi i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët është pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor dhe ndihmon mësuesin të kuptojë se sa mirë po i mësojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat e kësaj lënde. Në lëndën e gjuhës së huaj qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm vendosja e një note, por:

- t'i japë nxënësit mundësi të kuptojë progresin e tij, të mësojë nga gabimet duke reflektuar të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë, si dhe të motivohet për të ecur përpara;
- të ndihmojë mësuesin të kuptojë sa mirë nxënësit i kanë kuptuar koncepte dhe po i zbatojnë ato;
- të ndihmojë mësuesin të përmirësojë mënyrën e mësimdhënies;

7.1 Llojet e vlerësimit në lëndën e gjuhës së huaj

Vlerësimi diagnostikues (vlerësimi si proces të nxënësi)

Ky lloj vlerësimi bëhet në fillim të vitit shkollor ose të një kapitulli të ri. Mësuesi zbulon njohuritë që nxënësi ka dhe identifikon çfarë ka nevojë të përsëritet ose të mësohet më mirë. Ky vlerësim ndihmon mësuesin të planifikojë më mirë mësimin, duke përshtatur ritmin dhe mënyrat e punës me nevojat e nxënësve.

Ky vlerësim mund të realizohet:

- me pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta;
- me ushtrime të shkurtra orientuese;
- me kuice të shkurtra;

- me lojëra ose biseda reflektuese,
- fisha vetëvlerësimi, etj.

Vlerësimi formues (vlerësimi i vazhduar, vlerësimi për të nxënë)

Ky vlerësim bëhet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, për të parë si po ecin nxënësit. Ai ndihmon nxënësit dhe mësuesin të kuptojnë nëse janë në rrugën e duhur dhe çfarë duhet përmirësuar në punën e tyre para se të arrijnë vlerësimin përmbledhës ose përfundimtar.

Teknika të vlerësimit formues janë:

- vlerësimi i punës në grupe;
- vëzhgimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes gjatë mësimi;
- detyrat e përditshme dhe projektet e vogla;
- vlerësimi i diskutimeve dhe argumentimi i zgjidhjeve;
- vlerësimi i përgjigjeve gjatë mësimi;
- vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët, etj.

Vlerësimi përmbledhës (vlerësimi periodik, vlerësimi i të nxënësit)

Ky vlerësim bëhet pas një periudhe mësimore, ose pas një kapitulli dhe mat atë që nxënësi ka arritur të mësojë. Mund të realizohet me teste, detyra individuale me shkrim, projekte përmbyllëse. Kjo zakonisht shoqërohet me notë dhe ndihmon mësuesin, nxënësin dhe prindërit të kuptojnë progresin dhe arritjet.

7.2 Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit në lëndën e gjuhës së huaj

- Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit të mësojnë më mirë, të kuptojnë dhe të reflektojnë mbi gabimet e tyre.

- Detyrat dhe pyetjet e vlerësimit duhet të matin aftësitë dhe njohuritë që nxënësit duhet të zhvillojnë sipas kompetencave të gjuhës së huaj.
- Vlerësimi duhet të jetë i qartë dhe i drejtë për të gjithë nxënësit, pavarësisht aftësive të tyre.
- Vlerësimi duhet të inkurajojë nxënësit të besojnë në vetvete dhe të kuptojnë që gabimi është pjesë e të nxënit.
- Mësuesi duhet të përdorë shumë forma vlerësimi, si: përgjigjet me gojë, ushtrimet, punën me materiale konkrete, projektet, vizatimet, punën në grup, detyrat e shtëpisë etj.

Ky proces ndihmon që vlerësimi të bëhet një mjet i dobishëm dhe i kuptueshëm për të gjithë, jo vetëm një "kontroll" për nota, por një mënyrë për të ndihmuar nxënësit të rriten dhe të përmirësohen çdo ditë në mësimin e gjuhës së huaj.

7.3 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.

Në këtë rubrikë përfshihen shembuj konkretë të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit në lëndën e gjuhës së huaj. Nëpërmjet shembujve mësuesit kuptojnë si të dallojnë dhe të vlerësojnë nxënësit mbështetur në nivelet e arritjes. Përmes përshkrimeve të qarta dhe të shkallëzuara, shembujt mbështetin procesin e vlerësimit formues dhe përmbljedhës. Në këtë rubrikë gjithashtu jepet një shembull për vlerësimin e detyrave me shkrim në gjuhën e huaj.

Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve në gjuhën frënge gjenden në aneksin 1 tabelat 10.

Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve në gjuhën italiane gjenden në aneksin 2 tabelat 10.

Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve në gjuhën gjermane gjenden në aneksin 3 tabelat 10.

8 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Gjatë procesit mësimor në lëndën e gjuhës së huaj, përdorimi i burimeve dhe aktiviteteve të ndryshme ndihmon në zhvillimin e aftësive komunikative dhe në kuptimin e thellë të strukturave gjuhësore. Materialet konkrete, vizuale dhe teknologjike krijojnë mundësi që nxënësit të mësojnë në mënyrë aktive, duke prekur, parë, dëgjuar dhe zbatuar njohuritë në situata reale. Mësuesi ka mundësinë të integrojë mjete të ndryshme për të bërë mësimin sa më të qartë dhe të aksesueshëm për të gjithë nxënësit dhe duke i ndihmuar ata të ndërtojnë dijet e tyre, t'i konkretizojnë njohuritë e tyre, të nxënë në mënyrë të pavarur, t'i përdorin dijet në jetën praktike dhe në kontekste të reja, të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues, të bashkëveprojnë me shokët e shoqet e klasës. Disa nga mjetet më të përdorura didaktike janë: tekstet mësimore, fletoret e punës, revistat, atlaset, enciklopeditë, antologjitë, televizori, video-projektori, kompjuteri, smartboard, interneti, CD, radio, media, Podcastet, aplikacionet ose platformat për mësimin e gjuhës, materialet mësimore të hartuara ose të përshtatura nga mësuesi, vepra letrare dhe libra të tjerë në gjuhë të huaja që janë në bibliotekën e shkollës, etj.

Gjatë shpjegimit, mësuesi përdor gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, fjali të shkurtra dhe një fjalor të përshtatur për moshën dhe nivelin e nxënësve. Ai/a jo zgjedh shembuj konkretë dhe ushtrime të personalizuar, duke siguruar mbështetje shtesë për nxënësit që kanë nevojë.

Përveç tekstit shkollor, mësuesi *përdor fletore pune, materiale ndihmëse, ushtrime shtesë dhe platforma digjitale*, që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe të zbatojnë më mirë gjuhën e huaj që po mësojnë.

8.1 Përdorimi i teknologjisë si mjet dhe teknikë mësimore

Në arsimin e mesëm të ulët, përdorimi i teknologjisë në orët e gjuhës së huaj është një mundësi shumë e mirë për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësitë e komunikimit, krijimtarisë dhe të kuptojnë lidhjen e gjuhës me kulturën dhe shoqërinë. Qasja interaktive, e cila përfshin përdorimin e platformave digjitale, aplikacioneve dhe burimeve multimediale, inkurajon nxënësit të angazhohen dhe të eksplorojnë tema të ndryshme në mënyrë kreative. Klasat e pajisura me mjete si tabela interaktive dhe burime online ndihmojnë në krijimin e një mjedisi mësimor motivues, ku gjuha

mësohet në një kontekst dinamik dhe praktik, duke i përgatitur nxënësit për sfida të ndryshme të komunikimit në botën reale. Më poshtë listohen disa mënyra për përdorimin e teknologjisë në lëndën e gjuhës së huaj.

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet e web –it të rekomanduara nga mësuesi si burim informacioni.
- Përdorimi i platformave digjitale për mësimin e gjuhëve (Akelius language learning platform)¹.
- Përdorimi i aplikacioneve të ndryshme për hartimin e testeve; pyetësorëve, etj.
- Përdorimi i tabelave interaktive për të angazhuar nxënësit në aktivitete interaktive, prezantime multimediale dhe lojëra virtuale.
- Përdorimi i përmbajtjeve multimediale si video, podkaste dhe filma për t'i ekspozuar nxënësit ndaj përdorimit autentik të gjuhëve dhe konteksteve kulturore.
- Etj.

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës së huaj do të përshkruhen përdorimi i burimeve dhe materialeve didaktike përfshirë teknologjinë.

¹ <https://languages.akelius.com/>

9 REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit të lëndës së gjuhës së huaj bazohet në Kornizën Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë, Planin Mësimor të Arsimit të Mesëm të Ulët si dhe në Kuadrin e Përbashkët Evropian për Gjuhët dhe Volumnin Shoqërues (2020). Si i tillë ky dokument i shërben mësuesve, autorëve të teksteve mësimore, hartuesve të testeve kombëtare, vlerësuesve të jashtëm të cilësisë, prindërve, nxënësve. Në këtë kapitull përshkruhen disa rekomandime për zbatuesit e programit në mënyrë që të maksimizohet efektiviteti i programit të lëndës së gjuhës së huaj.

a) Rekomandime për mësuesit

- Të lidhin përmbajtjen e gjuhës së huaj me fusha të tjera (shkencë, matematikë, teknologji, inxhinieri, art, gjuhë, edukatë qytetare, etj.) për të ndihmuar në zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve.
- Të përdorin situata nga jeta reale, si role-play, diskutime mbi tema aktuale, dhe projekte që lidhen me interesat e nxënësve për të rritur angazhimin e tyre në procesin mësimor.
- Të inkurajojnë nxënësit të eksplorojnë tema të ndryshme në mënyrë të pavarur përmes kërkimeve dhe prezantimeve, duke u dhënë atyre mundësinë të zhvillojnë aftësi kërkimore dhe prezantuese.
- Të planifikojnë aktivitete praktike që e ndihmojnë nxënësin të kuptojë rëndësinë e gjuhëve të huaja në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me profesione të ndryshme.
- Të shfrytëzojnë mjetet digjitale dhe platformat online për të krijuar një mjedis më interaktiv, duke përdorur video, podcast dhe burime të tjera për të përparimin e nxënësve.
- Të fokusohen në zhvillimin e aftësive të larta, si mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve, përmes analizës së teksteve, debateve dhe studimeve të rasteve.
- Të inkurajojnë nxënësit të eksplorojnë kulturën e vendeve ku flitet gjuha e huaj që ata po mësojnë duke përdorur literaturë, muzikë, filma

dhe aktivitete kulturore, për të rritur ndjeshmërinë kulturore.

- Të organizojnë ditën evropiane të gjuhëve si një manifestim i shumë gjuhësisë dhe shumë kulturave.
- Të japin feedback të vazhdueshëm dhe konstruktiv për të ndihmuar nxënësit të përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore dhe të kuptojnë më mirë boshllëqet e tyre.
- Të inkurajojnë nxënësit të zhvillojnë projekte që përfshijnë përdorimin e gjuhës së huaj në mënyrë kreative, si krijimi i videove, blogeve ose aplikacioneve.
- Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për fëmijët me aftësi me talente.
- Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socio emocional.
- Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata nga pakicat kombëtare dhe grupe të marginalizuara.
- *Të sigurojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të lëndës së gjuhës së huaj (p.sh. sugjerohet 30% teori — 70% praktikë). Përdorimi praktik i gjuhës së huaj do të realizohet jo vetëm në orët e veçanta si: ushtrime, përsëritje, projekte, konkurse etj., po përgjatë çdo ore mësimore. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.*
- Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës së gjuhës së huaj.
- Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

b) Rekomandime për autorët e teksteve shkollore

- Të përshtatin në mënyrë cilësore tekstet shkollore duke reflektuar të gjitha përditësimet më të fundit.
- Të përfshijnë platforma digjitale interkative për mësimin e gjuhës së huaj, në tekstet shkollore.
- Të sigurojnë librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së tekstit shkollor.
- Të sigurojnë materialet burimore edhe digjitale për zbatimin e tekstit shkollor.

- Të përfshijnë në tekstet shkollore ushtrime që promovojnë mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve dhe krijimtarinë.
- Të krijojnë hapësirë në tekstet shkollore për shembuj dhe ushtrime që nxisin orientimin për karrierë, përmes profesioneve ku gjuha e huaj luan rol të rëndësishëm.
- Të sigurojnë që tekstet të kenë qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për moshën, duke marrë parasysh diversitetin kulturor dhe aftësitë e ndryshme të nxënësve.
- T'i referohen tabelës së vendosur në fund të programit e cila pasqyron përputhjen e niveleve gjuhësore sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe shtrirjen e tyre sipas klasave në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

c) Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare

- Të sigurojnë që testet të përmbajnë ushtrime me fokus zbatime praktike në jetën reale.
- Të integrojnë qasje ndërdisiplinore, që nxisin të menduarit logjik, të menduarin kritik dhe krijues, jo thjesht memorizimin.
- Të sigurojnë që testet të jenë të përputhshme me objektivat e programit dhe rezultatet e të nxënësve, për të reflektuar aftësitë që nxënësit duhet të zhvillojnë.
- Të kenë parasysh nivelin e diversitetit të nxënësve, duke përfshirë ushtrime që janë të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë, pavarësisht sfondit kulturor ose gjuhësor.
- Të respektojnë balancën mes aftësive gjuhësore që testohen.
- Të hartojnë modele të testeve kombëtare në mënyrë që të punohen nga nxënësit gjatë viteve të shkollimit.

d) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.
- Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve gjuhësore.

- Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- Të vlerësojnë organizimin e punës në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- Të vlerësojnë balancën midis kohës që flet mësuesi dhe kohës që flasin nxënësit.
- Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënit dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socio emocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e gjuhës së huaj.
- Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabël.

e) Rekomandime për prindërit

- Të inkurajojnë fëmijët që të kuptojnë rëndësinë e të mësuarit të gjuhëve të huaja jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- Të bashkëpunojnë me shkollën për të ndihmuar fëmijët në pjesëmarrjen në projekte të lidhura me gjuhët e huaja.
- Të promovojnë një qëndrim pozitiv ndaj mësimi të gjuhëve të huaja, duke theksuar rëndësinë e përpjekjes dhe të mësimi nga gabimet.
- Të sigurojnë që fëmijët ndihen të mbështetur emocionalisht dhe që mësimi i gjuhës së huaj zhvillohet në një atmosferë të qetë dhe motivuese për fëmijët e tyre.

f) Rekomandime për nxënësit

- Të marrin pjesë aktive në orët e mësimi të gjuhës së huaj, duke kërkuar të kuptojnë përdorimin praktik të njohurive.
- Të angazhohen në projekte kurrikulare që lidhin gjuhët e huaj me lëndët e tjera.
- Të bashkëpunojnë me shokët dhe të mësojnë të komunikojnë lirshëm në gjuhën e huaj që po mëson si në klasë ashtu edhe jashtë saj.
- Të jenë kureshtarë dhe të kërkojnë ndihmë kur hasin vështirësi, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe burimeve online.
- Të kuptojnë rëndësinë e gjuhëve të huaja si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.

10 NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE

Në lëndën e gjuhës së huaj së klasës së gjashtë dhe të shtatë ka këto ndryshime përmbajtjesore:

- 1) Reflektim i ndryshimeve të bëra në Kuadrin Evropian të Referencave për Gjuhët, Volumi Shoqërues, 2020. ²
- 2) Vendosja e fokusit në qasjen e orientuar drejt veprimit duke sugjeruar një ndarje brenda orës së mësimi 50% pjesa teorike dhe 50% pjesa praktike. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
- 3) Promovimi i shumë gjuhësisë dhe shumë kulturave gjuhësore.
- 4) Përditësimi i kompetencave kyç dhe i rezultateve të të nxënëtit të përshtatura për klasën e gjashtë dhe të shtatë.
- 5) Përditësimi dhe përshkrimi në gjuhë të huaj i kompetencave të lëndës dhe i rezultateve të të nxënëtit.
- 6) Përditësimi i rezultateve të të nxënëtit duke shtuar komunikimin online dhe ndërmjetësimin gjuhësor dhe kulturor.
- 7) Riorganizimi i veprimtarive gjuhësore dhe strategjive në formën e rezultateve të të nxënëtit.
- 8) Përditësimi i temave ndërkurrikulare.
- 9) Përditësimi i metodologjisë me fokus të shtuar në zhvillimin e mendimit kritik, edukimin për median dhe informacionin, qëndrueshmëria mjedisore, të nxënëtit bazuar në projekt, si dhe duke përfshirë qasjen STEAM, të nxënëtit e personalizuar, të nxënëtit socio emocional, përdorimin e teknologjisë dhe IA etj.
- 10) Përditësimi i vlerësimit të nxënëtit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënëtit.

² Council of Europe (2020), *Common European Framework of Reference for Languages: Learning, teaching, assessment – Companion volume*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, available at www.coe.int/lang-cefr

11 TABELA E NIVELEVE SIPAS KLASAVE

Tabela pasqyron përputhjen e niveleve gjuhësore sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe shtrirjen e tyre sipas klasave në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë për gjuhën e huaj të dytë.

Nivelet Klasat	A1	A2	A2+/B1
Klasa 12			
Klasa 11			
Klasa 10			
Klasa 9			
Klasa 8			
Klasa 7			
Klasa 6			

12 ANEKSI 1- GJUHË FRËNGE

Tabela 1. Kompetencat e lëndës së gjuhës së huaj dhe rezultatet e të nxënësve

Compétences	Description	Résultats d'apprentissage
Compétence linguistique	La compétence linguistique porte sur les caractéristiques formelles d'une langue, telles que la grammaire, la phonologie, la morphologie, le lexique et la syntaxe. Au niveau A1, l'accent est mis sur la conscience phonologique et phonémique, le lexique, les expressions simples et les phrases courtes.	Étendue linguistique générale - L'élève: - utilise des mots ou des signes isolés et des expressions simples pour donner des informations simples sur soi.
		Étendue du vocabulaire Pas de descripteur disponible.
		Correction grammaticale - utilise des règles très simples pour l'ordre des mots ou des signes dans des phrases courtes.
		Maîtrise du vocabulaire Pas de descripteur disponible.
		Maîtrise phonologique Pas de descripteur disponible.
		Maîtrise de l'orthographe Pas de descripteur disponible.

Compétence sociolinguistique	La compétence sociolinguistique concerne la dimension socioculturelle de l'usage de la langue, comme les règles de politesse ou les répertoires des groupes sociaux, les expressions de la sagesse populaire, les dialectes, etc. Au niveau A1, l'accent est mis sur les règles de politesse ou les répertoires des groupes sociaux.	Adéquation sociolinguistique	- établit un contact social de base en utilisant les formes polies les plus simples du quotidien pour saluer et dire au revoir ; se présenter ; dire s'il vous plaît, merci, désolé, etc.
Compétence pragmatique	La compétence pragmatique couvre l'utilisation fonctionnelle du langage, par exemple son utilisation dans des structures spécifiques, des structures communicatives et des scénarios expliquant comment se comporter lors d'un événement	Souplesse	Pas de descripteur disponible.
		Prise de parole	Pas de descripteur disponible.
		Développement thématique	Pas de descripteur disponible.
		Cohérence et cohésion	Pas de descripteur disponible.
		Précision	- communique des informations très élémentaires sur des détails personnels de façon simple.

	social donné ou comment participer à une discussion ou à un entretien. Au niveau A1, l'accent est mis sur l'utilisation simple de structures communicatives.	Aisance	- se débrouille en prononçant des phrases très courtes, isolées et répétées, à l'aide de gestes et en demandant de l'aide quand cela est nécessaire.
--	--	----------------	--

Tabela 2. Fushat tematike, njohuritë kryesore gramatikore dhe funksionet gjuhësore

Njohuri dhe koncepte – Klasa 6-7	
Formimi kulturor dhe ndërkulturor	
Domaine	Thèmes
Vie personnelle et sociale	La vie personnelle : (moi et ma famille, ma maison, ma chambre, mon corps, les tâches ménagères, les repas, la nourriture, le temps libre et les loisirs, les fêtes, les jeux vidéo, Les données personnelles, les plans personnels, les sentiments personnels.
Education	La vie scolaire : l'école, les copains, les réseaux sociaux, les matières scolaires, l'emploi du temps, les activités scolaires (excursions et voyage avec la classe, visites, art, sport etc.), les règles à l'école.
Emplois et professions	Les professions et les lieux de travail. Le genre des professions.

Le monde autour de nous	L'environnement, le jardin, le parc, les plantes, les animaux, le temps, les jours de la semaine, les mois de l'année et les saisons
Enjeux mondiaux	Les droits de l'enfant, la nature, la terre, l'environnement.
Formimi gjuhësor	
Gramatika	
Adjectifs et adverbess	Les adjectifs les plus fréquents, les adjectifs de couleur, les adjectifs possessifs et les adjectifs démonstratifs, les adjectifs de nationalité, les adjectifs interrogatifs. Le genre, le nombre et l'accord des adjectifs. La place de l'adjectif. Les adverbess de quantité, les adverbess de lieu, les adverbess de temps. Adverbess interrogatifs : ou, quand, comment
Les articles les conjonctions et les prépositions	Les articles indéfinis, les articles définis, les articles partitifs, les nombres. Les conjonctions : mais, et, pour. Les prépositions de temps et de lieu. La cause : pourquoi/ parce que
Les verbes	Le présent des verbes et des auxiliaires, le futur proche, le passée récent, l'impératif. Le passé composé. La négation
Noms et pronoms	Le genre et le nombre des noms, Les pronoms personnels, les pronoms toniques,

Funksionet gjuhësore	
Les fonctions linguistiques	Saluer et prendre congé. Présenter et se présenter de manière simple, Décrire simplement l'école et la classe Décrire les amis de manière simple Donner et demander des informations personnelles. Parler de ses goûts et de ses préférences. Donner et demander des informations sur des habitudes quotidiennes. Inviter, accepter, refuser Exprimer des sentiments et émotions.

Tabela 3. Veprimtaritë që zhvillon nxënësi për marrjen e informacionit të shpjeguar në formën e rezultateve të të nxënit

ACTIVITÉS DE RÉCEPTION	
<i>Compréhension orale</i>	
<i>Compréhension générale de l'oral</i>	
L'élève:	
- comprend des questions et des affirmations courtes et très simples, à condition qu'elles soient prononcées clairement et lentement, illustrées par des gestes ou des images facilitant la compréhension et qu'elles soient éventuellement répétées.	

- reconnaît des mots et des signes familiers, à condition qu'ils soient prononcés clairement et lentement dans un contexte clairement défini, quotidien et familier. - reconnaît des nombres, des prix, des dates et les jours de la semaine à condition qu'ils soient prononcés clairement et lentement dans un contexte clairement défini, quotidien et familier.
L'élève: <i>Comprend des annonces et des instructions orales</i> - comprend des instructions courtes et simples comme par exemple « Stop », « Fermez la porte », etc. à condition qu'elles soient prononcées lentement en face-à-face, accompagnées de visuels ou de gestes et éventuellement répétées. <i>Comprend des médias audio ou signés et des enregistrements</i> - reconnaît des mots, des signes, des noms et des chiffres connus, dans des enregistrements courts et simples, à condition que le débit soit lent et la langue claire.
<i>Compréhension audiovisuelle</i>
<i>Comprendre des émissions de télévision, des films et des vidéos.</i> - identifie le sujet d'un document vidéo à partir d'informations visuelles et d'un savoir préalable.
Compréhension écrite
<i>Compréhension générale de l'écrit</i>

L'élève reconnaît des mots et des signes familiers accompagnés d'images, comme un menu de restauration rapide illustré par des photos ou un livre d'images utilisant un vocabulaire familier.

L'élève:

Comprend la correspondance

- comprend dans une lettre, une carte ou un courriel, l'événement auquel il(elle) est invité(e), ainsi que le jour, l'heure et le lieu de l'invitation.
- reconnaît des horaires et des lieux dans des notes et des messages très simples venant d'amis ou de collègues, par exemple « Je reviens à 4 heures » ou « Dans la salle de réunion », à condition qu'il n'y ait pas d'abréviations.

Lit pour s'orienter

- comprend des panneaux très simples qui font partie de la vie quotidienne comme « Parking », « Gare », « Salle à manger », « Interdiction de fumer », etc.
- trouve des informations sur les lieux, les dates et les prix sur des panneaux d'affichage, des prospectus, des affiches.

Lit pour s'informer et discuter

- comprend des documents informatifs extrêmement simples, comme un menu de restauration rapide avec des photos ou une histoire illustrée formulée avec des mots quotidiens très simples.

Lit des instructions

- comprend des instructions très courtes et très simples, données dans un contexte familial et quotidien, comme « Défense de stationner », « Défense d'apporter des boissons ou de la nourriture » surtout si elles sont illustrées.

Tabela 4. Veprimtaritë që zhvillon nxënësi kur prodhon informacion të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënit

ACTIVITÉS DE PRODUCTION
<i>Production orale</i>
<i>Production orale générale</i>
L'élève produit des phrases courtes pour parler de soi, donner des renseignements simples personnels (par exemple, le nom, l'adresse, la situation familiale, la nationalité).
<i>L'élève:</i>
<i>Monologue suivi: décrire l'expérience</i>
- parle de soi (nom, âge, famille) en utilisant des mots ou des signes et des expressions toutes faites, à condition de pouvoir préparer à l'avance. - exprime ses sentiments en utilisant des gestes, le langage corporel et des mots comme « heureux », « fatigué ».
<i>S'adresse à un auditoire</i>
- produit une série d'expressions et de phrases simples reliées par des connecteurs simples tels que « et », « mais » et « parce que ».

PRODUCTION ÉCRITE
<i>Production écrite générale</i>
L'élève donne des renseignements simples et personnels (par exemple le nom, l'adresse, la nationalité) en utilisant éventuellement un dictionnaire.
L'élève: <i>Écriture créative</i> - écrit des salutations très simples dans des messages et des cartes postales; - écrit des phrases courtes et très simples sur un sujet familier; - complète les espaces vides avec des mots faisant référence aux images; - décrit ses amis, sa famille, ses personnages, ses objets, ses animaux et ses objets préférés avec des mots très courts et décousus et des phrases très simples; - écrit son nom, son adresse et son âge sur un formulaire très simple.

Tabela 5. Veprimtaritë që zhvillon nxënësi kur ndërvepron me të tjerët, të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënësit

ACTIVITÉS D'INTERACTION
<i>Interaction orale</i>
<i>Interaction orale générale</i>

L'élève pose des questions et répondre à des questions sur lui (elle)-même et sur ses habitudes quotidiennes, en utilisant des formules toutes faites courtes et en comptant sur les gestes pour renforcer l'information donnée.

L'élève:

Comprend un interlocuteur

- comprend des questions simples qui le (la) concernent directement (par exemple sur son nom, son âge et son adresse), si on l'interroge lentement et clairement.
- comprend une information personnelle simple (par exemple le nom, l'âge, l'adresse, l'origine) quand quelqu'un se présente directement, lentement et clairement, et comprend des questions qui lui sont adressées sur ces mêmes sujets, bien qu'elles doivent parfois être répétées.
- comprend certains mots ou signes familiers et reconnaître des informations clés (par exemple des chiffres, des prix, des dates, les jours de la semaine) à condition qu'on les lui dise et qu'on les répète très lentement si nécessaire.

Conversation

- comprend et utilise des formules toutes faites telles que « Oui », « Non », « Excusez-moi », « S'il vous plaît », « Merci », « Non merci », « Désolé(e) ».
- reconnaît de simples salutations.
- salue, donne son nom et prend congé d'une manière simple.

Obtient des biens et des services

- fait des achats simples et/ou commande à manger ou à boire si des gestes (comme montrer du doigt) peuvent appuyer ses paroles.

Échange des informations

- donne son nom et demande leur nom à d'autres personnes.
- utilise et comprend des nombres simples dans les conversations courantes.
- demande et indiquer le jour, l'heure et la date.
- demande et donner une date de naissance.
- demande et donner un numéro de téléphone.
- dit son âge et demander l'âge des gens.
- pose des questions très simples pour obtenir des informations, par exemple « Qu'est-ce que c'est ? », et comprend un ou deux mots ou signes de la réponse.

INTERACTION ÉCRITE

Interaction écrite générale

L'élève transmet des informations très simples (par exemple son nom, son adresse, sa famille), avec des phrases courtes, sur un formulaire ou une note, en utilisant un dictionnaire.

L'élève:

Correspondance

- écrit des phrases courtes pour donner des renseignements personnels simples en utilisant un dictionnaire.

Notes, messages et formulaires

- remplit des formulaires d'inscription très simples avec des renseignements personnels très simples : nom, adresse, nationalité, situation familiale.

Interaction en ligne

Conversation et discussion en ligne

- Publie des messages simples de salutation en ligne, en utilisant des expressions toutes faites simples.
- publie des messages simples en ligne pour se présenter (par exemple sa situation de famille, sa nationalité, son métier), à condition de pouvoir choisir dans une liste de mots et/ou d'utiliser un outil de traduction en ligne.

Transactions et coopération en ligne axées sur des objectifs

- choisit (par exemple un produit, une taille, une couleur) dans un simple formulaire d'achat ou de demande en ligne, à condition de disposer d'un support visuel.

Tabela 6. Veprimtaritë që zhvillon nxënësi gjatë ndërmjetësimi gjuhësor, të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënësit

ACTIVITÉS DE MÉDIATION
Dans la médiation, l'élève agit en tant qu'agent social qui crée des ponts et aide à construire ou à transmettre du sens, parfois dans la même langue, parfois à travers des modalités (par exemple, de l'oral au signé ou vice versa, dans la communication cross-modale) et parfois d'une langue à une autre (médiation interlinguistique). L'accent est mis sur le rôle de la langue dans des processus tels que créer l'espace et les conditions pour communiquer et/ou apprendre, collaborer pour construire un nouveau sens, encourager les autres à construire ou à comprendre un nouveau sens, et transmettre de nouvelles informations sous une forme appropriée. Le contexte peut être social, pédagogique, culturel, linguistique ou professionnel.
MÉDIATION GÉNÉRALE
L'élève utilise des mots simples ou des signes pour demander à quelqu'un d'expliquer quelque chose. Reconnaît les difficultés et indique en langage simple la nature apparente d'un problème. Transmet les points principaux de conversations ou de textes courts et simples sur des sujets quotidiens d'intérêt immédiat à condition qu'ils soient exprimés clairement et dans un langage simple.
MÉDIATION DE TEXTES
L'élève: <i>Transmet des informations spécifiques à l'oral ou par signes</i> - transmet (en langue B) des instructions simples (données en langue A) concernant des lieux et des horaires à condition qu'elles soient répétées très lentement et clairement. - transmet (en langue B) des informations très élémentaires (par exemple des nombres et des prix) données dans des textes courts, simples

et illustrés (en langue A).

Transmet des informations spécifiques à l'écrit

- énumère (en langue B) des noms, des nombres, des prix et des informations très simples de textes (écrits en langue A) d'un intérêt immédiat, rédigés dans une langue très simple et comprenant des illustrations.

Tabela 7. Strategjitë që përdor nxënësi, të shpjeguara në formën e rezultateve të të nxënësit

